Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË SHËRBIMIT SPITALOR KLINIK UNIVERSITAR TË KOSOVËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kërkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Valbon Krasniqi, Drejtor i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës

Agreta Gecaj- Gashi, Kryesuese e Bordit Drejtues të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës

Adresa: Lagjia e spitalit , Prishtinë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Gjashtë pagesa nga investimet kapitale në vlerë 1,691,711€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive në SIMFK.

A1 Pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet ishin të nënvlerësuara për 934,252€ në PFV.

B2 Detyrimet kontigjente nuk ishin raportuar sipas Rregullores për Raportim Vjetor Financiar, kjo pasi që ishin të mbivlerësuara për 211,552€ ndërsa janë nënvlerësuar për 683,251€

A2 Një faturë në vlerë prej 183,473€ nuk ishte shpalosur në PFV si obligim edhe pse fatura ishte pranuar në muajin dhjetor/2020.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A3 Kontrata për "Sigurimin fizik të objekteve të QKUK" ishte ndryshuar pa bazë ligjore duke shkaktuar pagesa jashtë kontratës bazë në vlerë totale 155,568€ për vitin 2020.

B3 SHSKUK ende nuk e ka vënë në funksion sistemin e-pasuria. Të dhënat ishin mbajtur në regjistër individual të secilit program pa ju nënshtruar normave të zhvlerësimit.

A4 Spitali i Ferizajt dhe Spitali i Gjilanit nuk kanë kryer inventarizimin e pasurisë për vitin 2020 me kohë, ndërsa programet tjera në kuadër të SHSKUK edhe pse kanë kryer inventarizimin raportet e inventarizimit nuk janë harmonizuar/krahasuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë, për të verifikuar saktësinë e informatave rreth pasurive.

A5 SHSKUK nuk ka regjistruar pagesat nga palët e treta në SIMFK në vlerë 7,909,162€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

1 Për vëmendjen tuaj, dëshirojmë të theksojmë faktin se SHSKUK kishte bërë pagesa nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në shumë prej 27,057€ si rezultat i buxhetimit të gabuar.
Përveç kësaj, SHSKUK kishte bërë edhe pagesa tjera nga kategoria e Mallrave dhe shërbimeve dhe investimeve kapitale në bazë të vendimeve gjyqësore në shumën prej 809,439€ për kompensimin e pagave jubilare, pagave përcjellëse dhe shpenzimeve tjera të procedurave gjyqësore.
Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuate kanë rezultuar me mbivlerësimin e kategorisë së mallrave dhe nënvlerësimin e kategorisë së pagave dhe investimeve.
Kjo kishte ndodhur për arsyen se:
(1) me rastin e aprovimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit 2020, këto shpenzime ishin planifikuar dhe ekzekutuar në kategori jo adekuate ekonomike; dhe
(2) për shkak të mungesës së fondeve buxhetore, të cilat me rastin e ndarjeve buxhetore nga Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave, detyrimet për paga në bazë të vendimeve gjyqësore nuk ishin marrë parasysh si detyrime rrjedhëse gjatë vitit dhe rrjedhimisht, nuk ishte ndarë asnjë fond kontigjent për kompensimin e tyre. Thesari kishte ekzekutuar pagesat nga fondet e ndara për kategoritë tjera.
Duke qenë se çështjet në fjalë janë mjaft të përhapura në shumë organizata buxhetore dhe po përsëriten për vite me radhë, ato do të trajtohen më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinioni i auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i SHSKUK është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i SHSKUK është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i SHSKUK është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikun 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike[4]



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Mos regjistrim i pasurisë në SIMFK

Gjetja	Sipas nenit 6.3 të rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK". Gjashtë [5] pagesa nga investimet kapitale në vlerë 1,691,711€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive në SIMFK. Një pjesë e këtyre pasurive ishte regjistruar në SIMFK gjatë vitit 2021. Arsyeja e mos regjistrimit të pasurive ishte mos komunikimi i duhur i drejtorive, për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia.
Ndikimi	Mungesa e regjistrit të saktë dhe të plotë rreth pasurisë, pamundëson një menaxhim dhe kontrollë efektive mbi pasuritë. Si rrjedhojë e mungesës së regjistrimit të pasurisë, vlera e pasurive në PFV është nënvlerësuar.
Rekomandimi B1	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se të gjitha njësitë bashkëpunojnë me zyrtarët e pasurive që të ketë një regjistër të plotë të pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Nënvlerësim i pasurive nën 1,000 dhe stoqeve në PFV

Gjetja

Pasqyrat financiare të SHSKUK janë si rezultat i konsolidimit të pasqyrave financiare të programeve të cilat përgatisin pasqyrat individuale.

Ne kemi identifikuar se pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet në PFV e konsoliduara ishin të nënvlerësuara për 934,252€. Informatat e detajuara mund të shihen si në vijim:

- ZKF i SHSKUK nuk kishte perfshirë në PFV vlerën prej 352,519€ të pasurive nën 1,000€ të raportuar nga Spitali i Ferizajt;
- Qendra e Shëndetit Mendor në raportin përmbledhës për të gjitha Qendrat kishte nënvlerësuar pasuritë nën 1,000€ për 262,492€; dhe
- ZKF i SHSKUK nuk kishte përfshirë në PFV vlerën prej 319,238€ të stoqeve të raportuar nga programet tjera.

Këto parregullsi kanë ndodhur pasi që kontrollet e brendshme nuk janë zbatuar në mënyrë konsistente gjatë vitit si dhe mos kontrollit të duhur gjatë konsolidimit.

Ndikimi

Pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet janë të nënvlerësuara dhe rrjedhimisht kjo është reflektuar edhe në prezantim jo të saktë të tyre në PFV.

Rekomandimi A1

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se para përgatitjes së PFV të konsoliduara kryhen kontrolle në mënyrë që pasuritë nën 1,000 dhe stoqet të paraqiten në vlera të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mangësi në raportim të detyrimeve kontingjente në PFV

Gjetja

Sipas nenit 18 të Rregullores MF Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore "Organizatat buxhetore në harmoni LMFPP raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente".

Ne kemi identifikuar se detyrimet kontigjente nuk ishin raportuar sipas Rregullores për Raportim Vjetor Financiar, kjo pasi që ishin të mbivlerësuara për 211,552€, ndërsa janë nënvlerësuar për 683,251€. Informatat e detajuara janë si në vijim:

- Spitali i Mitrovicës kishte raportuar si detyrime kontigjente në PFV 181,148€ edhe pse, kjo vlerë ishte shpenzuar përmes vendimeve gjyqësore nga Thesari;
- Spitali i Vushtrrisë kishte raportuar si detyrime kontigjente në PFV 30,404€ edhe pse, kjo vlerë ishte shpenzuar përmes vendimeve gjyqësore nga Thesari;
- Spitali i Ferizajt nuk kishte raportuar vlerën prej 130,596€ në PFV; dhe
- Spitali i Gjakovës nuk kishte raportuar vlerën prej 552,655€ në PFV.

Këto parregullsi kanë ndodhur pasi që kontrollet e brendshme nuk janë zbatuar në mënyrë konsistente gjatë vitit si dhe gjendja e krijuar nga pandemia.

Ndikimi	Mos prezantimi i saktë i ngjarjeve ekonomike të ndodhura gjatë vitit ka ndikuar që detyrimet kontingjente të mos paraqiten saktë në PFV.
Rekomandimi B2	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se njësitë evidentojnë detyrimet kontigjente si dhe përfshirjen e tyre të saktë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Nënvlerësim i obligimeve të papaguara në PFV

Gjetja	Sipas nenit 17.3 të Rregullores MF nr.01/2017 për Raportim Financiar Vjetor, "Organizatat Buxhetore duhet t'i raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) e krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues". Gjatë testimit kemi vërejtur se një faturë në vlerë 183,473€ për "Ndërtimin e objektit për nënë dhe fëmijë" obligimi nuk ishte shpalosur në PFV edhe pse fatura ishte pranuar në muajin dhjetor/2020. Kjo kishte ndodhur për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia.
Ndikimi	Mos prezantimi i obligimit ka ndikuar që ato të nënvlerësohen dhe rrjedhimisht kjo është reflektuar edhe në prezantim jo të saktë të tyre në PFV
Rekomandimi A2	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se në PFV të shpalosen vlerat e sakta të obligimeve të papaguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Ndryshimi pa bazë ligjore i kontratës për "Sigurim të objekteve të QKUK-së"

Gjetja	Sipas kontratës jo kornizë të datës 14.11.2019 për tre muaj me mundësi vazhdimi deri në zhvillimin e procesit për lidhjen e kontratës së re për "Sigurimin fizik të objekteve të QKUK", vlera e shërbimeve është 97,633.65€ në muaj, dhe ky çmim duhet të jetë e vetmja pagesë që QKUK i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve. Me datë 19.12.2019 ishte bërë ndryshim plotësimi i kontratës bazë ku me kërkesë të menaxherit të kontratës ishte shfuqizuar çmimi total me TVSH, ku do të mbizotërojë çmimi për njësi (orë pune me TVSH), të gjitha kushtet tjera mbesin të njëjta si në kontratën bazë. Ky ndryshim kishte shkaktuar pagesa të shërbimeve të realizuara për orë pune shtesë sipas kërkesës nga drejtorët e disa Klinikave të QKUK - së. Totali i pagesave jashtë kontratës bazë gjatë vitit 2020 ishte 155,568€. Për më tepër zyra e prokurimit nuk kishte kërkuar vazhdimin e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, krahas shtyrjes së periudhës së ekzekutimit apo periudhës, se sa kontrata ishte aktive. Sigurimi i ekzekutimit ishte i vlefshëm deri më 27.06.2020, derisa kontrata kishte zgjatur deri në shkurt 2021, si pasojë e ankesave të operatorëve ekonomik në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik. Zhvillimi jo i duhur i procedurës së prokurimit ka shtyrë që të kryhen pagesa jashtë kontratës.
Ndikimi	Ndryshimi i çmimit të përcaktuar paraprakisht në kontratën bazë ka ndikuar në pagesa jashtë kontratës bazë si dhe ka paraqitur mungesë të kontrollave dhe menaxhim të dobët të kontratës.
Rekomandimi A3	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që të zhvillohen procedurat adekuate të prokurimit në mënyrë që të evitohen pagesat jashtë kontratës bazë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mos aplikimi i sistemit e-pasuria

Gjetja	Sipas nenit 6.3 të Rregullores – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, pasuria jo kapitale duhet të regjistrohet në sistemin “e pasuria”. Gjithashtu sipas nenit 22.3 "Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t’i nënshtrohen normave të zhvlerësimit". Në SHSKUK në shumicën e programeve (Spitale dhe njësitë tjera) pasuritë nën 1,000€ nuk ishin evidentuar në sistemin e-pasuria. Të dhënat ishin mbajtur në regjistër individual të secilit program, pa ju nënshtruar normave të zhvlerësimit dhe në bazë të këtyre regjistrave janë hartuar PFV-të. E-pasuria nuk është funksionale përkundër përpjekjeve nga zyrtarët e SHSKUK dhe kërkesës për funksionalizim.

Ndikimi Mbajtja e regjistrit të pasurisë nën 1,000€, në Excel, përveç që është në kundërshtim me rregulloren, rritë rrezikun e fshirjes së pasurisë e që mund të ndikojë në keqpërdorimin apo humbjen e pasurisë.

Rekomandimi B3 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mangësi në inventarizim të pasurisë

Gjetja Sipas nenit 18.1 të Rregullores – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, "Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare". Gjithashtu sipas nenit 24 të po të njëjtës rregullore "Pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurisë jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare".

Spitali i Ferizajt dhe Spitali i Gjilanit nuk kanë kryer inventarizimin e pasurisë për vitin 2020 me kohë, ndërsa programet tjera në kuadër të SHSKUK - së edhe pse kanë kryer inventarizimin raportet e inventarizimit nuk janë harmonizuar/krahasuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë, për të verifikuar saktësinë e informatave rreth pasurive.

Inventarizimi nuk është kryer për shkak të gjendjes së krijuar me Covid 19, ndërsa harmonizimi nuk është kryer për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme, për sa i përket fushës së pasurisë.

Ndikimi Mos inventarizimi dhe mos harmonizimi i regjistrit të pasurive me inventarizim reflekton në mungesë të informatave të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim.

Rekomandimi A4 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se është kryer inventarizimi i pasurisë me kohë si dhe pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mos regjistrim i pagesave nga palët e treta në SIMFK

Gjetja Sipas nenit 9.6 të Rregullorës 01/2017 për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore "Të gjitha pagesat nga palët e treta duhet të regjistrohen në SIMFK në harmoni me procedurën përkatëse dhe të prezantohen në pasqyrat financiare".

SHSKUK nuk ka regjistruar pagesat nga palët e treta në SIMFK në vlerë 7,909,162€ e cila ishte prezantuar te shënimi 13 Pagesa nga palët e treta në PFV.

Zyrtarët përgjegjës nuk ishin në njohuri rreth kërkesave ligjore për regjistrimin e palëve të treta në SIMFK.

Ndikimi	Mos regjistrimi i pagesave nga palët e treta në SIMFK ka ndikuar që Ministria e Financave të mos ketë njohuri për këto pagesa, me ç'rast RVF e Buxhetit të Republikës së Kosovës është nënvlerësuar për këtë shumë.
Rekomandimi A5	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që pagesat nga palët e treta regjistrohen në SIMFK.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2020 ishte 45,177,949€, prej tyre ishin shpenzuar 42,679,377€. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzimet për blerjen e barnave nga lista esenciale për nivelin dytësor dhe terciar, por edhe shpenzime tjera. Kemi testuar 98 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 6,827,087€ si dhe 12 procedura të prokurimit.

Çështja A6 - Mos amandamentimi i kontratës sipas njoftimit nga KRPP

Gjetja	Sipas njoftimit nga KRPP, i datës 10.09.2020, pika tre, "AK - të mund të shtojnë sasitë e specifikuara në kontratat në fuqi (Kontratat Publike Kornizë), qoftë edhe për pozicion për të gjithë artikujt, pozicionet për të cilat është shtuar nevoja e AK - ve që të bëjnë porositë e artikujve të tillë pavarësisht kufizimeve (+ 30%) dhe/ose NUK obligohen të bëjnë porositë me qëllim të realizimit të 70% të sasive indikative të vendosura në dosjen e tenderit, përkatësisht në kontratë. Bazuar në rrethanat e lartpërmendura, Autoritetet Kontraktuese dhe në mbështetje të neneve përkatëse me marrëveshje miqësore me OE, të bëjnë amendamentim të kontratave në fuqi duke i përshtatur ato me nevojat aktuale, si rezultat i situatës së " forcës madhore " dhe përmbushjes më të mirë të kontratave përkatëse (ndryshohen sasitë e parashikuara)". Gjatë testimit të pagesës në vlerë prej 3,252€ nga kontrata kornizë "Furnizim me material shpenzues jashtë listës esenciale", në Spitalin e Përgjithshëm në Ferizaj, në vlerë 74,205€ kemi vërejtur tejkalim për tre [7] pozicione më shumë se 30%. Zyra e prokurimit nuk e kishte amandamentuar kontratën bazuar në njoftimin e KRPP - së, për të përshtatur sasitë me nevojat aktuale. Kjo kishte ndodhë për shkak të rritjes së numrit të pacienteve të shtrirë në Spitalin e Ferizajt, të shkaktuar nga Covid-19. Amandamentimi i kontratës nuk është kryer si pasojë e neglizhencës.
Ndikimi	Tejkalimi i kontratës kornizë pa amandamentimin e saj (sipas njoftimit të KRPP - së), përveç që është në kundërshtim me ligjet në fuqi, mund të ndikojë edhe në mos arritjen e vlerës për para.
Rekomandimi A6	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Spitalit duhet të sigurojnë që në rastet kur kërkohet të tejkalohen sasitë si pasojë e situatës së "forcës madhore" të bëhet amandamentimi i kontratës bazuar në njoftimin e KRPP.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Mangësi në menaxhim të kontratës

Gjetja

Sipas nenit 18.29 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, "Çmimet e deklaruara në tender dhe çmimet e mëtejshme në kontratat e dhëna janë çmime fikse dhe të obligueshme për palët e kontratës. Çmimet nuk mund të ndryshohen gjatë kohëzgjatjes së kontratës". Gjithashtu sipas nenit 61.19 Menaxheri i Projektit do të "Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuara në kontratë dhe sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë".

Ne kemi vërejtur se kontrata për ”Pastrimin e brendshëm dhe të jashtëm të hapësirave të objekteve“ në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan, e lidhur me datë 30.09.2019, me afat 36 muaj, me çmim të kontratës 21,634€ në muaj ishte ndryshuar me datë 27.01.2020 në bazë të një marrëveshje me OE, që të zbritet vlera e faturës mujore nga 21,634€ në 19,628€. Sipas marrëveshjes është kërkuar që "mundësisht SHSKUK të na ndihmoj me shumën e premtuar në vit" edhe pse marrëveshja nuk ishte nënshkruar nga drejtori i SHSKUK - së. Si pasojë e mos planifikimit të duhur më datë 29.07.2020 në kontratë ishin përfshirë edhe tri objekte tjera duke rritur vlerën për 619€ pa ndryshuar dhe amandamentuar kontratën sipas Rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik.

OE fitues gjatë zbatimit të kontratës nuk iu kishte përmbajtur kushteve të parapara në kontratë për dokumentimin e dëshmive me dokumete burimore, për angazhimin e 49 punëtorëve me pagë mujore bruto 302€, një përgjegjës me pagë 350€ bruto dhe një menaxher me pagë 380€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e planifikimit dhe ekzekutimit të kontratës.

Ndikimi

Mos implementimi i kontratës në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe kushtet e veçanta të përcaktuara në kontratë paraqet mungesë të kontrolleve dhe menaxhim të dobët të kontratës.

Rekomandimi A7

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Spitalit duhet të sigurojnë se planifikimi i mjeteve, nevojave dhe specifikimi i shërbimeve duhet të përgatitet dhe projektohet para fillimit të tenderimit. Më tutje duhet të sigurojnë përmes menaxherit të kontratës që asnjë faturë nuk pranohet pa u siguruar se të gjitha pagesat për stafin e angazhuar të kryhen sipas kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Nënshkrimi i kontratave në mungesë të zotimit të mjeteve

Gjetja

Sipas nenit 15.5 të Rregullës Financiare 01/2013, "Asnjë kontratë nuk duhet të nënshkruhet pa zotim të gjeneruar nga SIMFK për vitin aktual fiskal. Zotimi i gjeneruar nga SIMFK është pjese përbërëse e kontratës".

Në nëntë [6] procedura të prokurimit për kontrata publike kornizë, kemi vërejtur se SHSKUK ka nënshkruar kontratë pa zotim paraprak të mjeteve për vitin aktual fiskal. Vlera totale e zotimit për vitin fiskal 2020 do të duhej të jetë 1,762,486€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia.

Ndikimi

Nënshkrimi i kontratës publike kornizë në mungesë të zotimit të mjeteve është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe rrezikon mos përmbushjen e kontratës apo zbatimin e vonshëm të saj.

Rekomandimi A8

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se asnjë kontratë nuk nënshkruhet pa zotimin paraprak të mjeteve për vitin aktual fiskal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Ndarja e tenderëve përmes përdorimit të procedurave minimale

Gjetja

Sipas nenit 17.6 të Ligjit për Prokurim Publik, "Autoriteti kontraktues nuk do të zgjedhë ose përdorë metoda të vlerësimit, që kanë për qëllim zvogëlimin e vlerës së kontratës për shërbime nën kufirin e përcaktuar të nenit 19 të këtij ligji; as pala kontraktuese nuk do të bëjë ndarjen e kërkesave të prokurimit për shumën e shërbimeve të ofruara me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për shërbime nën kufirin e përcaktuar të nenit 19 të këtij ligji".

Nga analiza e raportit të kontratave të nënshkruara kemi vërejtur se:

- Spitali i Prizrenit gjatë vitit 2020 ka nënshkruar tetë kontrata përmes procedurave me vlerë minimale për servisim të auto ambulancave në vlerë totale 7,887€;
- Spitali i Mitrovicës gjatë vitit 2020 ka nënshkruar katër kontrata përmes procedurave me vlerë minimale për servisim të veturave në vlerë totale 3,880€; dhe
- Spitali i Vushtrrisë brenda një dite ka nënshkruar dy kontrata me një OE përmes proceduarave me vlerë minimale për Furnizim me reagenca në vlerë totale 1,930€.

Mos planifikimi i duhur i prokurimit dhe gjendja e krijuar nga pandemia ka shkaktuar ndarjen e tenderëve, duke nënshkruar procedura me vlerë minimale për shërbime të njëjta.

Ndikimi Ndarja e tenderëve duke përdorur procedurën me vlerë minimale, bën që SHSKUK t`i shmanget procedurave të hapura, si pasojë, shërbimet në këtë mënyrë mund të ofrohen me çmime më të larta, kualitet më të ulët dhe të mos arrihet vlera për paranë e shpenzuar.

Rekomandimi A9 Bordi Drejtues dhe Drejtorët e Spitaleve përkatëse duhet të sigurojnë që kërkesat e prokurimit duhet të përmblidhen qartë dhe me kohë nga njësitë kërkuese për të eliminuar nevojën për procedura të shpeshta dhe përdorimin e procedurave minimale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas nenit 18 pika 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 MF Shpenzimi i parasë publike - shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël.

SHSKUK në vitin 2020 ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 38,000€ në kategori ekonomike jo adekuate nga vet organizata. Informatat më në detaje janë si në vijim:

- Pagesa në vlerë 20,000€ sipas kontratës për “Rregullimin e kulmit në repartin e Gjinekologjisë - kërkesë emergjente” në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan është paguar nga kategoria e mallrave por këto shpenzime për nga natyra i takojnë investimeve kapitale; dhe
- Pagesa me vlerë 18,000€ në Spitalin e Përgjithshëm në Pejë (pajisje), është paguar nga kategoria e mallrave por këto shpenzime për nga natyra i takojnë investimeve kapitale.

Kjo kishte ndodhur për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia ku nevojat urgjente për investime kanë shtyrë të bëhen keq klasifikime.

Ndikimi Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të SHSKUK, duke mbivlerësuar/ nënvlerësuar kategoritë ekonomike.

Rekomandimi B4 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme nga Drejtorët e Spitaleve përkatëse në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A10 - Blerja e oksigjenit pa procedura të prokurimit

Gjetja Sipas nenit 21.2 të Rregullores Financiare 01/2013- MF, Shpenzimi i Parave Publike, "Shpenzimet që nuk kërkojnë prokurim janë: Pagat, shpenzimet e paguara me para 'e imët', avancat për udhëtime, komunalit, subvencionet dhe Transferet, transaksionet ndërdepartamentale".

Pagesa në vlerë 20,709€ në Spitalin e Vushtrrisë, kishte të bënte me blerjen e oksigjenit për nevojat e spitalit. Blerja e oksigjenit ishte kryer pa ndjekur procedurat e prokurimit. Pagesa është ekzekutuar përmes vendimeve gjyqësore, pasi që zyrtarët përgjegjës për procedim të pagesës nuk kanë kryer pagesën dhe OE ka dërguar lëndën te përmbaruesi privat dhe ka fituar rastin.

Sipas Drejtorit të Administratës në Spitalin e Vushtrrisë nevojat emergjente për shkak të situatës së krijuar me Covid kanë shtyrë spitalin që të kërkojnë zgjidhje rreth sigurimit të oksigjenit.

Ndikimi Blerja e oksigjenit pa procedura të prokurimit përveç që është në kundërshtim me rregulloren, ka ndikuar edhe në shpenzime shtesë pasi që spitali nuk ka kryer pagesën dhe OE ka dërguar lëndën te përmbaruesi privat dhe ka fituar rastin.

Rekomandimi A10 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Spitalit, duhet të sigurojnë se në rastet emergjente të shpenzimeve të përdorin procedurën e negociuar sipas Ligjit të Prokurimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 10,579,098€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 7,092,604€. Ato kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve speciale mjekësore, ndërtimin e objekteve shëndetësore etj. Kemi testuar 22 mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 3,166,486€, si dhe tetë procedura të prokurimit.

Çështja A11 - Mos nënshkrim i kontratës me kohë dhe mos porositja e pajisjes

Gjetja	Sipas nenit 22.3d të Rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik "Pas publikimit të Njoftimit për dhënie të kontratës, Autoriteti Kontraktues do të nënshkruaj kontratën". Procedura e prokurimit "Furnizim me Pajisje Mjekësore për Klinikën e Onkologjisë" në QKUK në vlerë 1,487,777€, njoftimi për dhënie të kontratës ishte publikuar me datë 10.12.2019 dhe sipas njoftimit data e planifikimit të nënshkrimit të kontratës ishte 12.12.2019. Kontrata ishte nënshkruar me datë 01.04.2020 rreth katër muaj pas planifikimit. Gjatë vitit 2020 nuk është lëshuar urdhërblerja nga SHSKUK për liferimin e pajisjes. Vonesa në nënshkrim të kontratës dhe mos porositja ka ndodh si pasojë e mungesës së mjeteve financiare.
Ndikimi	Vonesa në nënshkrimin e kontratës dhe porositjes së pajisjes ndikon në mos ofrimin e shërbimeve të duhura për pacientët.
Rekomandimi A11	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojnë, nënshkrimin e kontratave dhe porositjen e pajisjeve me kohë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A12 - Vonesa në vlerësimin e tenderëve për procedura të prokurimit

Gjetja	Sipas nenit 41.2 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik "Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve".

Procedura e prokurimit "Furnizim me Cardiac Electrophysiology System" hapja e ofertave ka ndodh më datë 16.01.2020 ndërsa vlerësimi i tenderëve është përfunduar më datë 23.03.2020 ose 65 ditë pas hapjes. Procedura e prokurimit "Furnizim me pajisje Mjekësore të Hemodializes për Klinikën e Nefrologjisë dhe Spitalet e Përgjithshme" hapja e ofertave ka ndodh më datë 10.02.2020 ndërsa vlerësimi i tenderëve ka filluar më datë 24.02.2020 ose 14 ditë pas hapjes. Procedura e prokurimit "Furnizim me aparat Laparoskop" në Spitalin e Prizrenit hapja e ofertave ka ndodh më datë 11.08.2020 ndërsa vlerësimi i tenderëve ka filluar më datë 19.08.2020 ose 8 ditë pas hapjes.

Vonesa në formim të komisionit ka qenë arsyeja e fillimit të vlerësimit me vonesë, ndërsa sipas menaxherit të prokurimit vlerësimi i tenderëve përtej afatit ka ndodh si pasojë e kompleksitetit të procedurës.

Ndikimi Vonesat në fillim dhe përfundim të vlerësimit të tenderëve mund të shkaktojnë anulimin e procedurave.

Rekomandimi A12 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se fillimi dhe përfundimi i vlerësimit të tenderëve të kryhet brenda afatit sipas legjislacionit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A13 - Blerja e veturës pa buxhet të miratuar

Gjetja Sipas nenit 17 të Ligjit nr.07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020 "Zyrtari Kryesor Administrativ i organizatës buxhetore është përgjegjësi kryesor ligjor për ekzekutimin e buxhetit, në pajtim me nenin 10 të LMFPP-së si dhe akteve nënligjore të aprovuara nga Ministri, përfshirë këtu edhe delegimin e shpenzimeve tek organizatat buxhetore. Gjithashtu sipas nenit 4 të po të njëjtit ligj "Miratohet buxheti i Republikës së Kosovës për vitin fiskal 2020 siç është i përcaktuar në tabelën 2 dhe tabelat 3.1 dhe 3.2., të bashkangjitura me këtë ligj".

Spitali i Gjakovës kishte blerë një veturë në vlerë 16,490€ edhe pse nuk kishte buxhet të miratuar për blerjen e veturës. Blerja ishte bërë nga buxheti i miratuar për inventar medicional.

Pakujdesia e personave përgjegjës të Spitalit të Gjakovës ka shkaktuar blerjen e veturës pa buxhet të miratuar.

Ndikimi Blerja e veturës pa buxhet të miratuar përveç që është në kundërshtim me Ligjin e Buxhetit, ka ndikuar edhe në mos realizimin e projektit e cili ishte miratuar sipas ligjit.

Rekomandimi A13 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Spitalit, duhet të sigurojnë se buxheti për investime kapitale ekzekutohet sipas projekteve të miratuara në ligjin e buxhetit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Çështjet e ndërlidhura me shpenzimet për menaxhimin e pandemisë Covid -19

SHSKUK ka shpenzuar 12,472,336€ për shpenzimet që lidhen me menaxhimin e pandemisë COVID nga Pako Emergjente Fiskale. Shpenzimet në vlerë 12,456,045€ janë paguar nga kategoria e pagave për shtesat mbi pagën bazë, ndërsa pjesa tjetër prej 16,291€ janë paguar nga mallrat dhe shërbimet për furnizime mjekësore dhe dezinfektues. Gjithashtu sipas PFV janë pranuar si donacione nga palët e treta për shpenzimet e COVID 2,823,759€ për barna dhe material harxhues.

Çështja A14 - Pagesat e shtesave për Covid-19 sipas vendimit të Qeverisë

Gjetja

Sipas pikës 1.6 të vendimit 01/2019 datë 30.03.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i ndryshuar me vendimin 06/25 datë 17.04.2020, Aprovohet Pakoja Emergjente Fiskale "Sigurimi i shtesës mbi pagë në vlerë prej 300€ për punëtorët në terren dhe që janë të ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në punën e tyre (jo i gjithë stafi i institucionit): Stafi mjekësor dhe mbështetës (mjekët, infermierët dhe personeli tjetër i ekspozuar rrezikut)". Gjithashtu sipas Vendimit 31-2/2020 datë 27.04.2020 të Ministrit të Financave dhe Transfereve për Planin Operacional për Pakon Fiskale Emergjente stafi administrativ nuk mund të përfitojë shtesa.

Gjatë analizës si dhe konfirmimit nga ana e personave përgjegjës nga të gjitha programet kemi vërejtur mos trajtim të barabartë të stafit ku në disa raste janë paguar shtesat për të gjithë stafin e në disa të tjera jo. Rastet janë paraqitur si në vijim:

- Në QKUK janë paguar shtesat për të gjithë stafin (përfshirë stafin administrativ), ndërsa punonjësit e administratës së SHSKUK - së nuk kanë përfituar shtesa;
- Në Spitalet e Përgjithshme Vushtrri dhe Ferizaj janë paguar shtesat edhe për një pjesë të administrates ndërsa në spitalet tjera nuk kanë përfituar shtesa pjesa e administrates;
- Në QKSUK janë paguar shtesat për të gjithë stafin; dhe
- Në Qendrat e Shëndetit Mendor janë paguar shtesat edhe për pjesën e administratës.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos interpretimit të drejtë të vendimit të Qeverisë.

Ndikimi

Mos trajtimi i barabartë i stafit rreth pagesës së shtesave për Covid 19 mund të ndikojë në menaxhimin jo të duhur të pakos fiskale si dhe mund të krijojë shpenzime pa mbulesë ligjore në buxhetin e dedikuar për paga.

Rekomandimi A14

Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të merr masa të menjëhershme që të sigurojnë zbatimin e vendimit të Qeverisë në mënyrë të saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[8]	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**118,714,401.00**	**132,065,296.42**	**126,021,739.47**	**124,163,113.13**	**84,993,518.73**
Grante Qeveritare - Buxheti	113,152,401.00	122,513,164.78	119,060,693.40	116,726,644.82	84,474,624.52
Financimi përmes huamarrjes	0.00	3,910,725.00	3,910,725.00	0.00	0.00
Te hyrat nga AKP-ja	5,562,000.00	5,562,000.00	3,025,295.41	7,354,528.26	498,810.81
Donacionet vendore	0.00	113.13	0.00	1,599.87	2,887.00
Donacionet e jashtme	0.00	79,293.51	25,025.66	80,340.18	17,196.40

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 13,350,894 €. Kjo rritje është rezultat i rritjes së buxhetit nga vendimet e Qeverisë si dhe ndryshimeve buxhetore nga rishikimi i Ligjit të Buxhetit.

Në vitin 2020 SHSKUK ka shpenzuar 95% të buxhetit përfundimtar në 2020 ose 126,021,739€, me një ulje 4% në krahasim me vitin 2019. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**118,714,401.00**	**132,065,296.42**	**126,021,739.47**	**124,163,113.13**	**84,993,518.73**
Pagat dhe mëditjet	57,190,921.00	76,308,249.55	76,249,758.81	62,736,816.67	58,242,229.68
Mallrat dhe shërbimet	42,301,064.00	42,373,480.36	39,877,708.58	40,972,358.95	13,659,910.59
Komunalitë	4,103,416.00	2,804,468.51	2,801,668.21	3,756,559.01	3,617,546.75
Investimet Kapitale	15,119,000.00	10,579,098.00	7,092,603.87	16,697,378.50	9,473,831.71

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:
• Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar më buxhetin fillestar ishte rritur për 19,117,328€. Ndryshimet kanë ndodhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi ndarjet Buxhetore për vitin 2020 (3,910,725€) dhe me vendim të Qeverisë (15,206,603€) kryesisht për shtesa mbi pagën bazë pas situatës së krijuar me Covid;
• Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar më buxhetin fillestar ishte rritur për 72,416€. Ndryshimet kanë ndodhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi ndarjet Buxhetore për vitin 2020 (zvogëlim për 620,000€) me vendim të Qeverisë (rritje e buxhetit për 664,952€) dhe rritje e buxhetit nga donacionet e jashtme për 27,464€;
• Buxheti final për shërbime komunale krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,298,947€. Ndryshimet kanë ndodhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi ndarjet Buxhetore për vitin 2020 (zvogëlim për 1,375,948€) dhe me vendim të Qeverisë është rritur buxheti për 77,001€;
• Buxheti final për investime kapitale krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 4,539,902€. Ndryshimet kanë ndodhur me Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi ndarjet Buxhetore për vitin 2020 në vlerë 3,542,815€ dhe me vendim të Qeverisë 997,087€.

SHSKUK ka shpenzuar në total 12,472,336€ për shpenzimet që lidhen me menaxhimin e pandemisë COVID nga Pako Emergjente Fiskale. Shpenzimet në vlerë 12,456,045€ janë paguar nga kategoria e pagave për shtesat mbi pagën bazë, ndërsa pjesa tjetër prej 16,291€ janë paguar nga mallrat dhe shërbimet për furnizime mjekësore dhe dezinfektues.

Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Rritja e shpenzimeve ndër vite ishte si rezultat i reformimit të sektorit të shëndetësisë, ku disa përgjegjësi kanë kaluar nga Ministria e Shëndetësisë te SHSKUK, siç është menaxhimi i listës esenciale me efekt në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Shpenzimet e pagave janë rritur këtë vit si pasojë e shtesave për menaxhimin e COVID, ndërsa shpenzimet për investime kapitale janë zbritur si pasojë e mos realizimit të projekteve nga situata e krijuar nga COVID.

Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020




Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	**2,390,779.00**	**1,989,159.00**	**1,677,809.20**	**3,302,175.83**	**2,743,090.55**
Të hyrat jo tatimore	2,390,779.00	1,989,159.00	1,668,728.51	3,302,175.83	2,738,090.55
Të hyrat tjera	0.00	0.00	9,080.69		5,000.00

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të SHSKUK ka rezultuar në 15 rekomandime kryesore. SHSKUK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. SHSKUK ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, gjashtë rekomandime janë zbatuar, katër nuk janë zbatuar ende dhe pesë nuk janë të aplikueshme më, siç është paraqitur në Grafikun 4, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Paraja në Arkë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet ti analizojnë arsyet për shpenzime të tilla dhe përmes njësive përkatëse të bëhët vlerësimi sa më i saktë i nevojave për blerje duke i përdorur procedurat e prokurimit dhe se fondet e parave të imta do të shfrytëzohen vetëm për blerje me vlera të vogla të cilat paraqiten në raste të pa parashikueshme.	Për shkak të situatës së krijuar me Covid ky rekomandim është i mbyllur për vitin 2020.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Të hyrat	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë përmes menaxherëve të financave që mbledhja e të hyrave mbi 10€ të realizohet përmes llogarisë bankare nga të gjitha spitalet dhe njësitë tjera. Nëse kjo është e parealizueshme atëherë si alternativë mbetet adresimi te Ministria e Financave për të ndryshuar rregulloren aktuale.	Ky rekomandim është i mbyllur për vitin 2020.	Nuk është i aplikueshëm më

3.	Pagat dhe mëditjet	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se menaxhmenti i të gjitha njësive të ShSKUK-së po ushtrojnë kontrolle në raportet mujore që procedohen për pagesën e kujdestarive duke u bazuar në ditarët e kujdestarive. Më tutje, të sigurohet se janë duke u aplikuar ligjet të cilat i rregullojnë çështjet e ndalesave për zyrtarët dhe funksionalizimin e plotë të sistemeve elektronike për evidentimin e vijueshmërisë në punë.	Për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia ky rekomandim nuk ishte I aplikueshëm për vitin 2020	Nuk është i aplikueshëm më
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se procedurat e prokurimit fillojnë sipas planit për kontratat që pritet të skadojnë, si dhe të marrin në konsideratë të gjitha pengesat dhe vonesat e mundshme në mënyrë që kontrata të lidhet para skadimit të kontratës aktuale.	Për shkak të situatës së krijuar me Covid ky rekomandim është i mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se përveç buxhetimit adekuat në vitin 2020 të mjeteve për servisim të pajisjeve mjekësore dhe liftave të bëjnë përpjekje maksimale për të eliminuar edhe keq klasifikimet tjera në mënyrë që të gjitha shpenzimet të paguhen nga kategoritë adekuate sipas planit kontabël.	Edhe gjatë vitit 2020 kemi hasur në keqklasifikim të shpenzimeve. Shih rekomandimin B4.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Investimet kapitale	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se menaxherët e kontratave raportojnë çdo largim nga termat dhe kushtet e kontratës duke arsyetuar me analiza specifike këto ndryshime dhe paraprakisht duhet të marrin aprovimin nga zyra e prokurimit dhe ZKA.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	4 Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë përmes menaxherit të kontratës që pajisjet të porositen vetëm pas renovimeve të nevojshme në mënyrë që të mos rrinë në depo, duke e humbur garancionin ende pa u instaluar pajisjet mjekësore	Gjatë vitit 2020 nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
8.	Investimet kapitale	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të kërkojnë nga menaxheri i prokurimit që procedurat të iniciohen me kohë dhe kriteret e vendosura të jenë analizuar mirë dhe të jenë në përputhje me rregullat e prokurimit përpara se të ndërmerren veprime për fillimin e procedurave të prokurimit.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
9.	Çështjet e përbashkëta	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se hartimi i specifikave teknike bëhet në atë mënyrë që të mos favorizojnë ose diskriminojnë ofertuesit e mundshëm	Gjatë vitit 2020 nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar


10.	Çështjet e përbashkëta	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se menaxherët e kontratave monitorojnë përmbushjen e kontratave duke siguruar se liferimi i pajisjeve bëhet sipas kushteve të kontratës, në të kundërtën duhet të aplikohen penalet sipas kontratës.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
11.	Çështjet e përbashkëta	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë ndarjen e drejtë të detyrave ndërmjet zyrtarëve të përfshirë në procesin e prokurimit. Zyrtarët të cilët janë të përfshirë në hartimin e specifikave nuk duhet të caktohen në vlerësimin e tenderëve si dhe këta të fundit nuk mund të angazhohen në menaxhim të kontratave.	Gjatë vitit 2020 nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
12.	Çështjet e përbashkëta	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur dhe të gjitha faturat e pranuara paguhen brenda afateve në mënyrë që të evitohen shpenzimet shtesë.	Ky rekomandim është i mbyllur për këtë vit. Edhe gjatë vitit 2020 ka shpenzime shtesë për vendimet gjyqësore - përmbarimore të cilat janë trajtuar tek theksimi i çështjes.	Nuk është i aplikueshëm më
13.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se të gjitha njësitë bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarët e pasurive që të ketë një regjistër të plotë të pasurive. Gabimet e evidentuara dhe ato të paevidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen dhe vlera e pasurive duhet të jetë reale. Po ashtu, duhet siguruar trajnime adekuate për zyrtarët e pasurive me qëllim që kompetenca të jetë në nivelin e duhur për të shmangur të gjitha paqartësitë me të cilat ballafaqohen zyrtarët e pasurive dhe të shqyrtohet mundësia e hartimit të ndonjë rregullore të brendshme për evidentim dhe menaxhim të pasurive.	Edhe këtë vit kemi hasur në mos regjistrim të pasurive në SIMFK. Shih rekomandimin B1.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Pasuritë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€. Po ashtu, pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive.	Edhe këtë vit E-pasuria nuk është funksionale. Shih rekomandimin B3.	Nuk ka filluar zbatimi

15.	Detyrimet Kontigjente	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë kontrolle efektive nga njësitë (Spitali i Gjilanit) në evidentimin e ngjarjeve dhe përfshirjen e tyre në PFV para se ato të konsolidohen sidomos te pjesa e shpalosjeve të informatave.	Edhe këtë vit ka pasur mangësi sa i përket detyrimeve kontigjente. Shih rekomandimin B2.	Nuk ka filluar zbatimi

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se të gjitha njësitë bashkëpunojnë me zyrtarët e pasurive që të ketë një regjistër të plotë të pasurive.
2.	Baza për opinion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se njësitë evidentojnë detyrimet kontigjente si dhe përfshirjen e tyre të saktë në PFV.
3.	Baza për opinion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se në PFV të shpalosen vlerat e sakta të obligimeve të papaguara.
4.	Baza për opinion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se para përgatitjes së PFV të konsoliduara kryhen kontrolle në mënyrë që pasuritë nën 1,000 dhe stoqet të paraqiten në vlera të sakta.
5.	Baza për konkluzion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e-pasuria për evidentimin e pasurive nën 1,000€.
6.	Baza për konkluzion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se është kryer inventarizimi i pasurisë me kohë si dhe pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive.
7.	Baza për konkluzion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që pagesat nga palët e treta regjistrohen në SIMFK.
8.	Baza për konkluzion	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që të zhvillohen procedurat adekuate të prokurimit në mënyrë që të evitohen pagesat jashtë kontratës bazë.
9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Spitalit, duhet të sigurojnë se në rastet emergjente të shpenzimeve të përdorin procedurën e negociuar sipas Ligjit të Prokurimit.
10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme nga Drejtorët e Spitaleve përkatëse në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.
11.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Spitalit duhet të sigurojnë që në rastet kur kërkohet të tejkalohen sasitë si pasojë e situatës së "forcës madhore" të bëhet amandamentimi i kontratës bazuar në njoftimin e KRPP.
12.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Spitalit duhet të sigurojnë se planifikimi i mjeteve, nevojave dhe specifikimi i shërbimeve duhet të përgatitet dhe projektohet para fillimit të tenderimit. Më tutje duhet të sigurojnë përmes menaxherit të kontratës që asnjë faturë nuk pranohet pa u siguruar se të gjitha pagesat për stafin e angazhuar të kryhen sipas kontratës.
13.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojnë se asnjë kontratë nuk nënshkruhet pa zotimin paraprak të mjeteve për vitin aktual fiskal.
14.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Bordi Drejtues dhe Drejtorët e Spitaleve përkatëse duhet të sigurojnë që kërkesat e prokurimit duhet të përmblidhen qartë dhe me kohë nga njësitë kërkuese për të eliminuar nevojën për procedura të shpeshta dhe përdorimin e procedurave minimale.
15.	Investimet kapitale	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Spitalit, duhet të sigurojnë se buxheti për investime kapitale ekzekutohet sipas projekteve të miratuara në ligjin e buxhetit.

16.	Investimet kapitale	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm, duhet të sigurojnë se fillimi dhe përfundimi i vlerësimit të tenderëve të kryhet brenda afatit sipas legjislacionit.
17.	Investimet kapitale	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm të sigurojnë, nënshkrimin e kontratave dhe porositjen e pajisjeve me kohë.
18.	Covid - 19	Bordi Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm duhet të merr masa të menjëhershme që të sigurojnë zbatimin e vendimit të Qeverisë në mënyrë të saktë.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Astrit Bllaca, Udhëheqës i Auditimit



Alban Beka, Udhëheqës i ekipit




Neslihane Mati, Anëtare e ekipit



Valbona Tolaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)
Bolnička i Klinička Univerzitetska Sluzba Kosova (BKUSK)
The Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, për vitin 2020 (në tekstin e mëtejmë "Raporti")

- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit

- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Dr. Valbon Krasniqi .....
Drejtor i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës
Data: 15.07.2021, Prishtinë

1

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[9] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.[10] . Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinioni mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)
Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin ‘theksim i çështjes’ ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç’pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] #701000886 PAISJE MJEKSORE në vlerë 24,900€; #701001260 Objekte shendetesore në vlerë 505,689€; #701000421 OBJEKTE SHENDETESORE në vlerë 373,161€; #701001261 Objekte shendetesore në vlerë 269,670€;#220201050 Ndertimi i Objektit per Themelimin e Laborato rit per Kateter në vlerë 125,089€ dhe #220201020 Avans per kontraten e nderteses per nena dhe femije ne SP Prizren në vlerë 393,202€

[6] Furnizim me barna nga lista esenciale për nevojat e SHSKUK-së,në vlerë 2,134,080€; Furnizim me barna kontrast nga lista esenciale për nevojat e SHSKUK-së, në vlerë 336,056€; Furnizim me barna nga lista esenciale për nevojat e SHSKUK-së, në vlerë 481,680€; Shërbimet e pastrimit dhe sanitarisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës-Ritender, në vlerë 4,808,609€; Furnizim me barna nga lista esenciale për nevojat e SHSKUK-së, në vlerë 2,470,490€; Furnizim me barna nga lista e re esenciale për nevojat e SHSKUK, në vlerë 1,242,752€,urnizim me material shpenzues reagensë jashtë listës esencial për klinikën e Biokimisë, në vlerë 152,835€; "Furnizim me material higjenik", në vlerë 87,920€; dhe "Servisimi dhe Mirëmbajtja e Pajisjeve për Radioterapi, Lot - 1", në vlerë 144,255€.

[7] Pozicioni 6. Kuti kartoni për hedhjen e mbeturinave te mbrehte 10L, sasia e kontraktuar ishte 250 copë, ndërsa janë furnizuar 1000 copë, Pozicioni 74. Maskë oksigjeni me gyp për fëmije , sasia e kontraktuar ishte 100 copë ndërsa furnizuar 200 copë, duke tejkaluar limitin për 100 copë; dhe Pozicioni 78. Kanillë nazale për oksigjen , sasia e kontraktuar ishte 70 copë ndërsa furnizuar 200 copë, duke tejkaluar limitin për 130 copë.

[8] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[9] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[10] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.